Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a-Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkencat Ekonomike/Juridike;
- b-Te kete te pakten 2 vite pervojë pune ne profesion ;
- c-Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze te Çertifikuara ose me Diplome;
- d-Te kete njohuri te mira te programeve kompjuterike baze;
- e-Te jete i pajisur me çertifikaten “Auditues i Brendshem ne Sektorin Publik”

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx
- b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f – Vërtetim për gjendjen gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të behet pranë Zyres së Administratës të Bashkisë Permet.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 19/06/2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20/06/2025, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Administratës, për shkak të moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015"Per veteqeverisjes vendore";
- g) Njohurote mbi ligjin Nr.152/2013"Per Nepunesin civil",I ndryshuar;
- h) Njohurite mbi Ligjin Nr.114/2015"Per auditimin e brendshem ne sektorin publik";
- i) Njohurite mbi urdhrin Nr.86,date 20.12.2015,te Ministrit te Financave"Per miratimin e Kodit te Etikes per Audituesit e Brendshem ne Sektorin Publik";

- j) Njohurite mbi Udhezimin Nr.12,date 05.06.2012,te Minsitrit te Financave,"Mbi procedurat e kryerjes se veprimtarise se Auditimit te Brendshem ne sektorin publik";

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhezimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

**NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA PERMET**



Nr 1758 prot
Date 05.06.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

**SHPALLJE
PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIM CIVIL
NË PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Specialist Sport , niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. Vendim Nr. 243, datë 18.03.2015 I ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive Bashkia Përmet shpall procedurën për plotësimin e vendeve të lira për pozicionin :

Specialist Kulture/Arsim/Sport

Kategoria IV-4

1 vend vakant

. Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LEVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
LËVIZJE PARALELE**

13.06.2025

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

19.06.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim dhe përgatit materialin që ia paraqet drejtorit për miratim, duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara;
2. Monitoron institucionet e varësise së arsimit parauniversitar në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, bazuar në planet e punës; .
3. Merr pjesë në hartimin e projekteve të edukimit dhe arsimimit si dhe planifikon programe dhe ndërhyrje afatshkurtra dhe afatmesme në zbatim të saj, duke propozuar përfshirjen e tyre në planet buxhetore;
4. Zhvillon takime me institucione dhe organizata që ofrojnë projekte sportive dhe komunitare në qytet dhe jashtë tij;
5. Siguron bashkëpunimin me institucionet e arsimit dhe shkencës për menaxhimin e terreneve sportive të shkollave;
6. Bashkëpunon me shkollat dhe OJF-te për të nxitur organizimin e sportit në shkollë;
7. Ideon nevojat për rikonstruktimin dhe modernizimin e plotë të ambienteve dhe palestrave në administrim të Bashkisë;

1 LËVIZJA PARALELE

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në një nga degët e Arsimit të Lartë
- b- Të kete eksperience pune të pakten 1 vit në administratën publike .
- c- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
- d- Të kete njohuri të mira të programeve kompjuterike baze

Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Përmet dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje e noterizuar e diplomës/listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Zyrën e Administratës së Bashkisë Përmet me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri ", kati katërt brenda datës 13.06.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14.06.2026, njësia përgjegjëse për burimet njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë listën e kandidateve që plotësojnë kushtet e levizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkurrimi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e levizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Bashkinë Përmet, në rrugë elektronike e-mail, telefonike për shkaket e mos kualifikimit .

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të ndryshuar
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

1.5 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe Stendat e Informimit publik.

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni, duke filluar nga data 14.06.2025

1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor" në një nga degët e Shkencave Shoqërore;
- b- Të ketë eksperience pune të pakten 1 vit në administratën publike ose private.
- c- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

d- Te kete njohuri te mira te programeve kompjuterike baze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx
- b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f – Vërtetim për gjendjen gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet pranë Zyres së Administratës të Bashkisë së Permetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 19/06/2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20/06/2025, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombëtar të Punësimit dhe në stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervistë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Administratës, për shkak të moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar
- Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

BASHKIA PERMET



PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL 19.06.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Implementimi dhe zbatimi i procedurave të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzime dhe ose të ardhura dhe garantimi i përputhshmërisë me ligjin
2. Zbatimi i buxhetit vjetor të institucionit dhe të gjitha vendimeve financiare
3. Rregjistrimi i të ardhurave
4. Rregjistrimi i shpenzimeve sipas ligjit brenda vitit financiar
5. Mbajtja e inventareve
6. Kontrolli i magazines dhe levizjeve të vlerave monetare dhe materialeve në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi
7. Ndjekja dhe llogaritja e të gjitha shpenzimeve të institucionit, sipas zerave të buxhetit

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca ekonomike";
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën financiare në sektorin publik apo privat.
- c- Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx

- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë

- Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër:

1- Do të bëhet në Zyren e Administres të Bashkisë Permet

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 13.06.2025

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 26.02.2025, Njësia e burimeve njerëzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkurrimi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Bashkinë Permet, në rrugë elektronike e-mail, telefonike për shkaqet e mos kualifikimit .

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7661 “Për kontabilitetin” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9136 “Per menaxhimin financiar e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë fituesin në portalin Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendat e informimit publik.

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta marrin, duke filluar nga data 14.06.2025.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" indryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca Ekonomike";
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën ekonomike në sektorin publik apo privat.
- c- Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx

b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f – Vërtetim për gjendjen gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të behet pranë Zyres së Administratës pranë Bashkisë Permet.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 19.06.2025

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20.06.2025** , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7661 "Për kontabilitetin" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9136 "Për menaxhimin financiar e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-Vlerësimin me shkrim deri në 60 pikë
- b-Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë
- c-Jetëshkrimin që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën deri në 15 pike

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

**NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA PËRMET**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 1757 prot.

Përmet, më 05.06.2025

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Sektori i MZSH-së

**PUNONJËS TË SHËRBIMIT TË MZSH-SË PËR NIVELIN BAZË TË SHËRBIMIT
VENDOR TË MZSH-SË, SEKTORI I MZSH-SË BASHKIA PËRMET**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 9/c, 14/1 e vijues të Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe të nenit 39 e vijues të VKM-së Nr.520, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe të Urdhrit nr.15, datë 015.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Përmet”, Bashkia Përmet shpall procedurat e konkurrimit për vendet e lira :

- Personel zjarrfikës, operues, luftues, 1 (një) pozicion (niveli bazë)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shurjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjës së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Zjarrfikësi është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjës së gjallë dhe pronës. Duhet të njoh dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njoh dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kandidatët për punonjës zjarrfikës duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "B";

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1. Formular aplikimi;
- 2. Fotokopje e kartës së identitetit;
- 3. Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- 4. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 5. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
- 6. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
- 7. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B";
- 8. Certifikatë e gjendjes gjyqësore;
- 9. Certifikatë familjare;
- 10. Vërtetim nga gjykata;
- 11. Vërtetim nga prokuroria;
- 12. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
- 13. Fotokopje e librezës së punës e njëzuar me origjinalin;
- 14. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- 15. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) cope.

Dokumentat duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pëmet brenda datës **13.06.2025**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONI

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Përmet do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Përmet dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohen testimet.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Përmet. Afati i ankimimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË

ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKM-së Nr.520, datë 25.7.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikant

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
- Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathhtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%. Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të marra dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Përmet do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë dhe në standat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Përmet. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE